



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

BULETINI MUJOR I SËMUNDJEVE NGJITËSE

Shtator, 2025

PËRMBAJTJA E BULETINIT

1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse gjatë muajit shtator 2025
2. Sëmundjet e raportuara në Kosovë, sipas komunave
3. Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse
4. Epidemitë e lajmëruara
5. Niveli i raportimit nga institucionet shëndetësore
6. COVID-19
7. Situata epidemiologjike në rajon dhe botë

QËLLIMI:

Që të përcillet dhe vlerësohet situata epidemiologjike me sëmundje ngjitëse në Kosovë, trendin e sëmundjeve ngjitëse, momentet me valide epidemiologjike, shkallën dhe kualitetin e raportimit të institucioneve shëndetësore me qëllim të përforcimit të parandalimit dhe përgjigjes epidemiologjike.

1. NUMRI I RASTEVE DHE VDEKJEVE NGA SËMUNDJET NGJITËSE GJATË MUAJIT SHTATOR 2025

Gjatë muajit shtator 2025 janë raportuar **17,339 raste** me sëmundje ngjitëse **Inc.(972.95 raste /100, 000 banorë)**. Ky numër i rasteve është më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit **2024 (26,846 raste apo Inc 1,506.41 raste/100,000)**. Sëmundjet të cilat prijnë me numër më të lartë të rasteve janë: **Diare ac. me 10,922 raste ose 612.87/100,000** **Influenca sezonale (ILI) me 4,759 raste ose 267.04/100,000** banorë, banorë, dhe **ARI/ITPR me 875 raste ose 49.10 në 100,000** banorë **(Tab.1)**.

Gjatë muajit shtator 2025 janë raportuar 6 raste të vdekjes nga sëmundjet ngjitëse: 3 raste me dg. Bronchopneumonia ac. me diagnozë përcjellëse, 1 rast me dg. Gastroenterocolitis ac. me diagnozë përcjellëse, 1 rast me AIDS dhe 1 rast me dg. Meningoencephalitis ac. me diagnozë përcjellëse

Tabela 1. Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse/ shkaktarëve të raportuara në Kosovë, shtator 2025

Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse/shkaktarëve të raportuar në Kosovë, 01 – 30 shtator të vitit 2024 dhe 2025				
Sëmundjet/shkaktarët	Shtator, 2024		Shtator, 2025	
	Nr.	Incidenca/ 100,000	Nr.	Incidenca/ 100,000
COVID-19	111	6.23	53	2.97
ITPR - Pneumonia/ARI	1607	90.17	875	49.10
SARI (forma e rëndë e pneumonisë)	12	0.67	13	0.73
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	10250	575.16	4759	267.04
RSV				
Diarea acute	14362	805.90	10922	612.87
Variçela	216	12.12	210	11.78
Sindromi meningjeal	17	0.95	15	0.84
Helmimet me ushqim	89	4.99	178	9.99
Rota virus	36	2.02	8	0.45
Salmonella enteritidis	5	0.28	1	0.06
Adenovirus	3	0.17	5	0.28
Gastroenterokolitet	41	2.30	73	4.10
Clostridium difficile	7	0.39	1	0.06
E.coli patogjene	1	0.06	4	0.22
Hepatiti akut B	2	0.11	3	0.17
Hepatiti akut C		0.00	2	0.11
Morbilli			1	0.06
Parotiti epidemik	3	0.17	2	0.11
Pertussis	13	0.73	1	0.06
Rubella				
Brucelosis	3	0.17	10	0.56
Tularemia	2	0.11	2	0.11
Toxoplasmosis	1	0.06		0.00
Sëmundja Lyme	2	0.11	0	0.00
Legionella			1	0.06
WNV	4	0.22	1	0.06
Leishmaniaza			1	0.06
Malarie				
HIV/AIDS	4	0.22	5	0.28
IST	33	1.85	51	2.86
TB			31	
Giardiaza	1	0.06	11	0.62
Entameba			1	
Enterovirus	3	0.17	1	0.06
Infeksioni streptokoksik i grupit A			1	
*Sëmundjet tjera ngjitëse	18	1.01	97	5.44
Gjithsej	26846	1506.41	17339	972.95
*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza				

1. SËMUNDJET NGJITËSE TË RAPORTUARA NË KOSOVË, SHTATOR 2025

Grupi i sëmundjeve që raportohen me formën e agreguar

Diarea akute: Gjatë muajit shtator 2025 në IKSHPK janë raportuar 10,922 raste me diare akute (Inc.612.87/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (14,362 raste), vërehet një ulje prej 23.95% dhe gjithashtu krahasuar me muajin gusht 2025, me 16,790 raste të raportuara, ulje prej 34.9% e rasteve të raportuara. Megjithatë numër ky i konsideruar i rasteve të raportuara i cili mbetet shqetësim për shëndetin publik, pasojë kjo e ekspozimit ndaj patogjenëve të ndryshëm në ushqim dhe ujë gjatë kësaj periudhe të vitit.

Influenca sezonale /ILI: Gjatë muajit shtator 2025 në IKSHPK janë raportuar 4,759 raste me ILI (Inc. 267.04/100,000 banorë). Sipas numrit të rasteve të raportuara vërehet rënie prej 53.57% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak me (10,250 raste) dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak, gusht 2025 me (4,954 raste të raportuara me ILI) vërehet ulje e lehtë prej 3.9%, si rrjedhojë e faktorëve si: qarkullimi i viruseve respiratore edhe jashtë sezonit (p.sh. adenoviruse, rinoviruse, SARS-CoV-2), grumbullimeve masive gjatë pushimeve verore, rritjes së lëvizjeve (turizmi, migracioni).

ARI/ITPR: Gjatë muajit shtator 2025 në IKSHPK janë raportuar 875 raste me ARI (Inc.49.1/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (1,607 raste) vërehet ulje prej 45.5% e numrit të rasteve të raportuara dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak gusht 2025 me (609 raste), ulje prej 43.67%.

Variçella: Gjatë muajit shtator 2025 në IKSHPK janë raportuar 210 raste me Variçellë (Inc.11.78/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 me (216 raste) vërehet ulje e lehtë prej 2.77% e rasteve të raportuara por krahasuar me muajin paraprak gusht 2025 me 180 raste të raportuara, rritje prej 16.6%.

Grupi i sëmundjeve që raportohen me formën individuale:

Sëmundjet vaksinëparandaluese

Gjatë muajit shtator 2025, në laboratorin e Mikrobiologjisë- IKShPK janë testuar 13 mostra të dyshimta me fruth ku 1 prej tyre është konfirmuar si rast pozitiv. Rasti pozitiv nga komuna e Prishtinës, i gjinisë mashkull, grup-mosha 3-5 vjeç, dhe i pavaksinuar.

Gjatë muajit shtator 2025, nga laboratori mikrobiologjik i IKShPK-së, gjithashtu janë konfirmuar 2 raste pozitive me Pertussis dhe 1 rast me Parotit. Rastet e konfirmuara me Pertussis, sipas komunave: Prishtinë dhe Obiliq me nga 1 rast. Sipas grup-moshës rastet i takojnë mbi 0-2 vjeç dhe mbi 18 vjeç me nga 1 rast. Njëri nga rastet me Parotit, ka status të rregullt vaksinal, derisa rasti tjetër me parotit dhe rasti me Pertussis kanë status vaksinal të pakompletuar.

Zoonozat dhe sëmundjet transmise

Gjatë muajit shtator 2025, nga ky grup i sëmundjeve janë raportuar 10 raste me Brucellozë dhe 2 raste me Tularemi. Sipas komunave rastet me Brucellozë: Rahovec (4 raste), dhe me nga dy raste komunat: Prizren, Podujevë dhe Vushtrri. Nga anketimi epidemiologjik rezulton se gjatë kësaj periudhe kemi të bëjmë me dy epidemi familjarenga komunat: Rahovec dhe Vushtrri. Rastet e raportuara nga Vushtrria sipas hulumtimit epidemiologjik rezulton se janë në kontakt të afërt me kafshë (dele), ndërsa ato nga Rahoveci mohojnë kontaktin me kafshë. Për rastet janë njoftuar zyret regjionale të AUV. Sipas gjinisë, 7 raste i përkasin gjinisë femërore dhe 3 raste gjinisë mashkullore. Sipas grup-moshës: 60–69 vjeç (2 raste), 50–59 vjeç (2 raste), 40–49 vjeç (1 rast), 30–39 vjeç (3 raste), 20–29 vjeç (1 rast) dhe 0–9 vjeç (1 rast).

Dy rastet e raportuara janë nga komuna e Ferizajt dhe të dy i përkasin gjinisë mashkullore. Sa i përket grup-moshës, me nga një rast: 60–69 vjeç dhe 20–29 vjeç

Nga sëmundjet transmise, gjatë muajit shtator janë raportuar:

1 rast me Virusin e Nilit Perendimor, nga komuna e Pejës. Rasti i takon gjinisë femërore dhe grup moshës 0-9 vjeç. Nga të dhënat epidemiologjike rezulton se rasti nuk ka udhëtuar jashtë vendit dhe 1 rast me Leishmania, nga komuna e Malishevës. Rasti i takon gjinisë mashkullore dhe grup moshës 0-9 vjeç

Sindroma meningjeale

Gjatë muajit shtator, 2025 janë raportuar 15 raste me Sindromë Meningjeale (Mb. 0.84/100 000 banorë), prej tyre 14 raste me Meningjit akut viral dhe 1 rast me Meningjit bakterial. Ky numër i rasteve të raportuara është më i ulët krahasuar me periudhën e vitit 2024, ku ishin të raportuara 17 raste.

Sipas komunave, janë raportuar 6 raste në komunën Prishtinë, me nga 2 raste në komunën e Fushë Kosovës, Lipjanit dhe Vushtrrisë, kurse me nga 1 rast komunat: Gjiilan, Ferizaj dhe Klinë, kurse Incidenca më e lartë e rasteve në 100,000 banorë është raportuar nga komuna e Fushë Kosovës me 6/100,000 banorë.

Sa i përket grup- moshës, gjatë kësaj periudhe, rezulton se numri më i madh i rasteve i takon grup- moshës 0-9 vjeç me 31.2% (6 raste), 30-39 vjeç me (2 raste), grup mosha 10-19 vjeç, 20-29 vjeç, 40-49 vjeç, 50-59 vjeç, 60-69 vjeç, 70-79 vjeç dhe mbi 80 vjeç me 6.6% (1 rast). Sipas gjinisë, rezulton se 53.3 % (8 raste) i takojnë gjinisë mashkullore dhe të gjinia femërore me 46.6 % (7 raste).

Nga mostrat humane të testuara në laboratorët e Mikrobiologjisë në IKShPK dhe laboratorin mikrobiologjik në Klinikën Infektive, janë izoluar 9 shkaktarë në LCS, prej tyre: me nga 2 raste Epstein Barr Virus dhe HHV6 dhe me nga 1 rast me Staphylococcus coagulaza negative, Varicela Zoster Virus, HHV7, HSV-1, HSV-2.

Gjatë kësaj periudhe është raportuar 1 rast i vdekjes me dg. Meningoencephalitis ac TBC, 72 vjeç, e gjinisë femërore nga Drenasi me dg. përcjellëse si: Insufficienca respiratoria, HTA.

Sëmundjet që barten me ujë dhe ushqim

Gjatë muajit gusht 2025, përmes SMSN nga të gjitha regjionet janë raportuar gjithsej 4,714 raste të sëmundjeve që barten me ujë dhe ushqim, prej të cilave: 3,284 raste me dg. Diarea dhe gastroenteritet me origjinë infektive të supozuar (AO9); 46 raste me dg. Infeksionet tjera intestinale bakteriale me shkaktarë të paspecifikuar (AO4.8); 45 raste me dg. Intoksikacionet tjera alimentare bakteriale (AO4.9); 9 raste me dg. Infeksion nga *Escherichia coli* prodhues i toksinës Shiga dhe/ose verocito-toksinës (STEC/VTEC, EHEC), Sindrom uremik hemolitik (*Escherichia coli*) (B96.22); 2 raste me dg. Giardiasis (*Giardia lamblia*) (AO7.1).

Sipas shkaktarëve të izoluar në Laboratorin e Mikrobiologjisë në IKSHPK dhe Kl. Infektive, janë raportuar: 9 raste me Rotavirus prej të cilave sipas komunave janë: 3 raste Gjakovë, nga 2 raste Prishtinë, Rahovec dhe nga 1 rast Mitrovicë, Malishevë. Sipas grup moshave: 9 raste janë të grup moshës 0-9 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 5 raste janë të gjinisë mashkullore dhe 4 raste të gjinisë femërore.

8 raste me *Giardia lamblia*, prej të cilave sipas komunave janë: 3 raste Mitrovicë, 3 raste Prizren dhe nga 1 rast Prishtinë dhe Ferizaj. Sipas grup moshave: 6 raste janë të grup moshës 0-9 vjeç dhe nga 1 rast i grup moshave 20-29 vjeç dhe 40-49 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 3 raste të gjinisë mashkullore dhe 5 raste të gjinisë femërore.

5 raste me Adenovirus, prej të cilave sipas komunave janë: 3 raste Mitrovicë, dhe nga 1 rast Gjakovë dhe Fushë Kosovë. Sipas grup moshave: 5 raste janë të grup moshës 0-9 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 3 raste të gjinisë mashkullore dhe 2 raste të gjinisë femërore, 1 rast me Enterovirus, nga komuna e Prishtinës. Rasti është i gjinisë mashkullore dhe grup moshës 0-9 vjeç, 1 rast me *Salmonella enteritidis*, nga komuna e Kaçanikut. Rasti është i gjinisë femërore dhe grup moshës 40-49 vjeç. 1 rast me *Clostridium difficile*, nga komuna e Kaçanikut. Rasti është i gjinisë femërore dhe grup moshës 40-49 vjeç dhe 1 rast me *Entamoeba histolytica*, nga komuna e Ferizajit. Rasti është i gjinisë mashkullore dhe grup moshës 40-49 vjeç.

Rast human me *Legionella* spp.

Gjatë muajit shtator është raportuar 1 rast me *Legionella* spp, nga komuna e Ferizajit. Rasti është fëmijë i moshës 3 muajore, i gjinisë mashkullore. Nga të dhënat epidemiologjike kuptojmë se pacienti jeton në shtëpi me kushte të mira të jetesës, në familje gjashtë antarëshe. Rasti nga muaji korrik është hospitalizuar 3 herë fillimisht në SR. të Ferizaj-it dhe pastaj në Kl. e Pediatrisë në QKUK. Gjatë hulumtimit epidemiologjik vërejmë se nuk ka raportime të rasteve të tjera me të njëjtën diagnozë. Ndërkaq Institucioneve shëndetësore ku u trajtua pacienti iu dhanë rekomandimet për ndërmarrjen e masave adekuate të parandalimit dhe kontrollit të infeksionit.

Sëmundjet/Infeksionet respiratore

Gjatë muajit shtator 2025, janë testuar 264 mostra të dyshimta në Influcencë dhe patogjenët tjerë respirator dhe 268 mostra të dyshimta në SARS CoV-2, të përzgjedhura nga qendrat sentinel.

Nga mostrat e testuara nuk është konfirmuar asnjë rast pozitiv me Influcencë A dhe B ndërsa nga patogjenët tjerë respirator janë konfirmuar 21 mostra pozitive me Human Adenovirus (ADV) apo 7.95%, 43 mostra pozitive me Human Rhinovirus (HRV) apo 16.28%, dhe 9 mostra pozitive me Parainfluenza Virus (PIV) apo 3.4 %.

Mbikëqyrja me Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë vazhdon sipas rekomandimeve të ECDC dhe OBSH për Influcencë me të dhënat e përditësuara nga mbikëqyrja epidemiologjike dhe virologjike. Duke pasur parasysh mungesën e sezonalitetit të parashikueshëm të SARS-CoV-2 dhe potencialin për rritje të aktivitetit, mbikëqyrja aktive duhet të vazhdojë gjatë gjithë vitit, në përputhje me udhëzimet e ECDC dhe OBSH. Intensiteti i Influcencës Sezonale për muajin shtator 2025 paraqitet në nivel të ulët të aktivitetit të qarkullimit.

Gjatë muajit shtator 2025 në IKSHPK janë raportuar 13 raste me SARI (Inc.0.73/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 me (12 raste) vërehet rritje e numrit të rasteve prej 8.3% dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak (22 raste), rënie prej 40.9%

Të gjitha rastet, sipas protokollit dhe kërkesave të klinikistit, u testuan së paku në tre viruse respiratore, SARS-CoV-2, Influcencë dhe RSV. Prej tyre rezultuan 5 mostra pozitive në SARS-CoV-2, 1 mostër pozitive në Human Adenovirus (ADV) dhe 1 mostër pozitive në Human Rhinovirus (HRV).

Rastet SARI sipas komunave janë: Prishtinë (5 raste), Fushë Kosovë (2 raste), Gjilan (2 raste) dhe me nga një rast komunat Gjakovë, Podujevë, Drenas, Mamushë. (Tabela 1)

Numri më i lartë i rasteve SARI sipas grup moshës është : 0-4 (7 raste), 15-34 (1 rast), 35-50 (1 rast), 51-64 (1 rast) dhe mbi 65 vjeç (3 raste). Sipas gjinisë, 8 prej tyre i takojnë gjinisë femërore dhe 5 gjinisë mashkullore.

Gjatë muajit shtator 2025, është raportuar një rast i vdekjes me SARI (CFR=7.7). Rasti i vdekjes i takon komunës së Gjilanit, gjinisë mashkullore, grup-mosha 65+, me sëmundje shoqëruese. Nga të gjitha rastet e raportuara SARI, në Klinikën Pediatrike u hospitalizuan 7 raste, ndërsa në Klinikën Infektive 6 raste, ku 1 prej tyre në Njësinë e Mjekimit Intensiv.

Në SMSN, gjatë muajit shtator 2025, janë raportuar 31 raste me Tuberkuloz apo 1.9 në 100,000 banorë. Sipas komunave: Prishtinë (8 raste), Lipjani dhe Gjilani me nga (3 raste), me nga (2 raste) komunat: Ferizaj, Deçan dhe Drenas, kurse komunat si: Gjakovë, Istog, Kaçanik, Klinë, Obiliq, Podujevë, Rahovec, Shtime, Viti, Vushtrri dhe Novobërdë me nga (1 rast). Prej 31 rasteve të raportuara, 27 (87%) janë raste pulmonare dhe forma ekstrapulmonare 4 (13 %). Nga forma pulmonare, të konfirmuara bakteriologjikisht janë 14 raste (51.8%). Sa i përket grup- moshës, gjatë kësaj periudhe, rezulton se grup- mosha më e prekur është ajo 60-69 vjeç me 13 raste apo (42%), 30-39 vjeç me 5 raste (16.1%), grup moshat 20-29 vjeç dhe 40-49 vjeç me nga 4 raste apo (12.9%), 50-59 vjeç me 3 raste apo (9.6%), kurse grup moshat 0-5 vjeç dhe 15-19 vjeç me nga 1 rast (3.2%). Sipas gjinisë, rezulton se gjinia mashkullore femërore me 51.6% (16 raste) kurse 48.3 % (15 raste) i takojnë gjinisë mashkullore.

Rastet me HIV/AIDS/IST

Gjatë muajit shtator 2025, janë raportuar 5 raste me HIV dhe një vdekje si pasojë e AIDS-it. Të gjitha rastet janë të gjinisë mashkullore. Një rast i takon grup moshës 15-24 vjeç, një 25- 34, dy raste 45-54 vjeç dhe një rast 55+. Dy raste janë nga komuna Vushtrri, një Prishtinë, një Mitrovicë dhe për një rast në fletë udhëzim mungon komuna. Katër raste janë të raportuara përmes SMSN/Klinika Infektive, një rast është dërguar për konfirmim nga OJQ CSGD dhe akoma nuk është lajmërua në Kl. Infektive për vizitë dhe konsultime.

Rasti exitus si pasojë e AIDS, është nga komuna Vushtrri, gjinia mashkullore, grup mosha 45-54 vjeç, të dhëna tjera nuk ka, meqenëse sipas informacioneve nga Klinika Infektive pacienti është spitalizuar në gjendje të rënduar shëndetësore dhe në mungesë të familjarëve apo të afërmeve.

Ecuria e Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme (IST)

Gjatë muajit shtator 2025 janë raportuar gjithsej 51 raste me Infeksione Seksualisht të Transmetueshme.

Rastet e raportuara janë nga komunat: Ferizaj 11 raste, Gjakovë 10 raste,, Pejë 8 raste,, Prishtinë 4 raste,, Prizren 3 raste,, Shtërpçë 3 raste,, Fushë Kosovë 2 raste, Klinë 2 raste,, Shtime 2 raste,, Viti 2 raste,, Gjilan 1 rast, Lipjan 1 rast, Podujevë 1 rast, dhe Skenderaj 1 rast. Sipas diagnozës: Chlamydia 31 raste, Condyloma 18, Gonorrhoeae 1 dhe Herpes gjenital një rast. Sipas gjinisë: 35 (69%) raste i takojnë gjinisë femërore dhe 16 (31%) gjinisë mashkullore. Sipas grup moshës: 15-24 vjeç i takojnë 20 raste (39%), 25-49 vjeç 30 raste (59%) dhe një rast mbi 50 vjeç (2%).

Hepatiti akut B dhe Hepatiti akut C

Gjatë muajit shtator, 2025, janë raportuar 3 raste me Hepatit akut B. Një (1 rast) nga komuna e Prishtinës (40 vjeç) i gjinisë mashkullore, (1 rast) nga komuna e Gjakovës (64 vjeç) i gjinisë mashkullore dhe 1 rast nga Prizreni (65 vjeç) i gjinisë mashkullore.

Me Hepatit akut C, gjatë kësaj periudhe janë raportuar 2 rase. Një (1 rast) nga Podujeva (25 vjeç) e gjinisë femërore dhe 1 rast nga komuna e Vushtrrisë (69 vjeç) e gjinisë femërore.

Rastet e sëmundjeve ngjitëse në Kosovë sipas komunave, shtator 2025

Tabela 2.

Annex 1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse sipas komunave Shtator 2025																																						
SËMUNDJA	Pneumoni a/ARI	SARI	ILI	Diarrhea ac	Variçell a	COVID- 19	Sindroma meningjeale	Meningjit serosa	Meningoen cephalit ac.	Morbilli	Parotiti s epidemi ca	Pertuss is	Hepatit ac. B	Hepatit ac. C	Helmin et me ushqim	Gastroe nteroko litet	Brucelo za	Tulare mi	Salmo nelloza	E.coli	Rotavir us	WNV	Adenov irus	Enterov isus	Leishm aniaza	Entamoeba histolit yca	Cl.diffic ile	IST	HIV	TB	**Mpox	Legionela	Giardia za	Infeksion et streptoko ksike të re të	Sëm.tjer a ngjitëse	Totali		
DEÇAN	0	0	56	185	1										11															2					2	257		
DRAGASH	29		27	89	4																																149	
DRENAS	15	1	64	161												2															2						245	
F.KOSOVË	1	2	33	93	15	3	2									8								1					2							1	161	
FERIZAJ	17		239	504	12	3				1						16		2									1		11		2		1	1		10	820	
GJAKOVË	5	1	222	248	4								1		1						3	3		1					10		1		2	1	10	513		
GJILAN	18	2	111	325	9					1																			1		3						470	
GRAÇANICË																																					1	1
H. I ELEZIT	0		15	92	0												1																			1	109	
ISTOG	3	0	101	205											21																	1					331	
JUNIK	0	0	4	14											2																						20	
KAÇANIK	0		128	209	3												3			1								1									346	
KAMENICË	0		185	344	0																																529	
KLINË	18	0	33	220	5			1							3																						283	
KLOKOT																																					0	
LEPOSAVIQ																																					0	
LIPJAN			46	114	3	2	1	1							3	3																					177	
MALISHEVË	2	0	39	107																	1					1					3						151	
MAMUSHË	0	1	24	97	2																																124	
MITROVICË	25		523	893	20	1										1						1		3						1				3		11	1482	
MITROVICË E VERIUT																																					0	
N. BËRDË	0		14	24	0																											1					39	
OBILIQ			66	103	2	1					1				1	2																1					177	
PARTESH																																					0	
PEJË	20	0	571	1063	7	3							1		32							1								8				1		7	1714	
PODUJEVË	3	1	127	66	8	3									1	2	1	2														1				1	217	
PRISHTINË	668	5	1042	2720	49	28		5	1	1	1		1		33	27					2				1						4	1	8		1	2	4600	
PRIZREN	33		342	1442	27	4							1		5		2													3				3		3	1865	
RAHOVEC	1	0	22	138	3	2											4					1										1				3	175	
RANILLUG																																					0	
SHTËRPCE																1																						4
SHTIME	11		130	106	1												1															2		1			252	
SKËNDERAJ	1		52	177	4																																235	
SUHAREKË	4		409	589	15																																	1017
VITI	0		100	160	3											1																						267
VUSHTRRI	1		34	434	13	3	1	1						1	63	4	2				1											2	1				44	605
Z. POTOK																																						0
ZVEÇAN																																						0
BURGU I LIPJANIT																																						0
PA ADRESË															1	2																						4
TOTALI	875	13	4759	10922	210	53	10	5	1	2	1	3	2	178	73	10	2	1	4	8	1	5	1	1	1	1	1	51	5	31	0	1	11	1	97		17339	
*Sëmundjet tjera ngjitëse: , Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza																																						

*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza

3. RASTET E SPITALIZUARA NË KLINIKËN INFEKTIVE, PEDIATRISË DHE SPITALET E PËRGJITHSHME, SHTATOR 2025

Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse në numër më të madh janë raportuar nga diaretë akute dhe gastroenterokolitet nga të cilat vetëm disa kanë konfirmim laboratorik të shkaktarit pasuar nga exanthemat, pneumonitë, infeksionet virale të traktit respiratorë, të cilat raportohen sipas diagnozës klinike. (shih Tabela 3).

Tabela 3. Rastet e spitalizuara me sëmundje ngjitëse në Klinikën Infektive, Pediatriisë dhe spitalet e përgjithshme, shtator 2025

Sëmundja	Rastet
Pneumonia /ARI	132
SARI	13
Hepatitis B	3
Sindroma meningjeale	15
Helmimet me ushqim	16
Diarea akute dhe gastroenterocolite	374
Status febrilis	14
Exanthema	83
Mononucleosis	2
Erysipela	10
Vulnus morsum viperi	2
Total	664

4. EPIDEMITË E RAPORTUARA GJATË MUAJIT SHTATOR 2025

Epidemia familjare me Brucellozë në Rahovec

Rasti i parë i Epidemisë familjare komuna e Rahovecit është konfirmuar më datë 11.09.2025. Gjatë hulumtimit epidemiologjik bëhet e ditur se familja nuk posedon fermë të deleve apo kafshë të tjera (para katër viteve kanë pasur në familje fermë të deleve). Rastet kanë deklaruar se qumështin e konsumojnë të blerë nga shitësit ambulantor të tregut në Rahovec. Të ekspozuar ishin 7 anëtarë të familjes, pre tyre 3 rezultuan pozitiv në Brucellë dhe 2 raste u hospitalizuan në Klinikën Infektive në Prishtinë. Ata kanë paraqitur ankesa me dhimbje të shpinës, lodhje dhe plogështi, simptoma të cilat kanë filluar që nga muaji gusht i këtij viti. Masat e ndërmarra: Vëzhgimi , hulumtimi i rasteve të reja , anketimi epidemiologjik , edukimi shëndetësor lidhur me sëmundjen shëndetësore.

Epidemia familjare me Brucellozë në Vushtrri

Epidemia familjare me Brucellozë në Stanoc të epërm të Vushtrrisë është zbuluar në fillim të muajit shtator. Pacientja me profesion amvise, ka pasur ankesa si: kokëdhimbje , dhimbje trupi, plogështi, mungesë apetiti, humbje peshe. Ankesat i kanë filluar para 1 muaj me heret. Pas përkeqësimit të gjendjes, transferohet në Klinikën Infektive me datë 06.09.2025 ku fillimisht pranohet me dg.Meningoencefalitis, pas disa ditësh merret mostra e gjakut për ASHB dhe Wright e cila rezulton pozitive. Gjatë anketimit epidemiologjik kuptojmë se pacientja jeton në shtëpi, në fshatin Stanoc i Epërm, komuna e Vushtrisë, në një familje me pesë anëtarë. Familja posedon rreth 50 krerë dele dhe pohon se me raste ka pasur edhe abort të deleve. Kafshë të tjera nuk kanë. Pacientja pohon se kafshët janë të vaksinuara dhe abortin e kafshëve e ka udhëhequr veterinari. Pacientja vetë as nuk konsumon qumështin apo djathin e tyre, por pohon se ka konsumuar mishin e tyre. Për kafshët përkujdeset bashkëshorti 34 vjeç, i cili me datë 23.09.2025, ka rezultuar pozitiv gjithashtu. Pacientja pohon se disa herë kanë shitur dhe kanë blerë dele. Në familje jetojnë gjithashtu edhe dy fëmijë: 4 vjeçar dhe 5 muajshe të cilët sipas deklarimit nuk kanë simptoma. Pë rastin në fjalë është njoftuar Agjencioni i veterines.

5. NIVELI I RAPORTIMIT NGA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

Për këtë periudhë, kanë raportuar 29 komuna ose 76.31% (29/38) e tyre. Komunitat të cilat nuk kanë raportuar: Graçanicë, Klokot, Leposaviq, Mitrovicë e veriut, Partesh, Ranillug, Shtërpce, Zveçan dhe Z.Potok.

Tabela 4. Raportimi i sëmundjeve ngjitëse nga institucionet shëndetësore përmes SMSN, shtator 2025

KOMUNA	Spitali i përgjithshëm	Klinika Infektive	Klinika e Pediatrisë	Klinika e Dermatove nerologjisë	Klinika e Pulmologjisë	QKMF	QMF	AMF	Gjithsej	Spitali i përgjithshëm	Klinika Infektive	Klinika e Pediatrisë	Klinika e Dermatoven erologjisë	Klinika e Pulmologjisë	Institucionet Private	KKTGJ	QKMF	QMF	AMF	Gjithsej
DEÇAN						205			205								40			40
DRAGASH						149			149								14			14
DRENAS						70			70								49	1		50
F. KOSOVË						41			41								77	21	86	184
FERIZAJ	19					661			680						1		75	57	4	137
GJAKOVË									0	47					22		273	173		515
GJILAN	1					420			421	26							61	87	2	176
GRAÇANICË									0											0
H. I ELEZIT						109			109											0
ISTOG						226			226								102	2		104
JUNIK						20			20								17			17
KAÇANIK						345			345								12			12
KAMENICË						529			529								8			8
KLINË						281			281								9			9
KLOKOT									0											0
LEPOSAVIQ									0											0
LIPJAN									0								164	6		170
MALISHEVË						151			151								135	11		146
MAMUSHË						124			124								62			62
MITROVICË	103					1378			1481								27			27
MITROVICË E VERIUT									0											0
N. BËRDË						38			38								5			5
OBILIQ						176			176								158	8	15	181
PARTESH									0											0
PEJË	35					1678			1713	206							45			251
PODUEJË						215			215								92	59		151
PRISHTINË		60	158	0	0	214	987	534	1953		70	17	10		5	8	16	1508	2	1636
PRIZREN	19					1519			1538	48					1		87	186		322
RAHOVEC									0						4			127	15	146
RANILLUG									0											0
SHTËRPCE									0											0
SHTIME						251			251								11			11
SKËNDERAJ						150			150								84			84
SUHAREKË						1017			1017								3			3
VITI						266			266								163	55		218
VUSHTRRI						227			227	90							43	151		284
Z. POTOK									0											0
ZVEÇAN									0											0
Gjithsej	177	60	158	0	0	10460	987	534	12376	417	70	17	10	0	33	8	1832	2452	124	4963

Gjatë muajit shtator 2025, përmes SMSN janë raportuar gjithsej 4,963 raste me sëmundje ngjitëse. Ky numër krahasuar me numrin e rasteve të raportuara me kopje fizike shënon një rritje prej 40.1 % të rasteve të raportuara përmes SMSN. (Tabela 4).


6. COVID-19

Gjatë muajit shtator 2025 janë testuar gjithsej 473 mostra të dyshimta për COVID-19, prej të cilave janë konfirmuar 53 raste pozitive me SARS-CoV-2, duke rezultuar me një shkallë pozitiviteti prej 11.2%. Nga këto raste, 43 pacientë janë shëruar, ndërsa rastet e mbetura janë në gjendje stabile. Gjatë këtij muaji nuk është raportuar asnjë rast i vdekjes. Krahasuar me muajin shtator 2024 (111 raste pozitive), vërehet një ulje e rasteve pozitive me 52.3%.

Rastet pozitive sipas komunave: Prishtinë me 28 raste, Prizren me 4 raste, me nga 3 raste komunat: Vushtrri, Ferizaj, Fushë Kosovë, Pejë dhe Podujevë, me nga 2 raste komunat: Lipjan dhe Rahovec dhe me nga 1 rast: Mitrovicë dhe Obiliq.

Sipas gjinisë: 34 raste (64%), të gjinisë femërore krahasuar me meshkujt me 19 raste (36%). Sipas grup-moshës: 0–9 vjeç (18 raste), 10–19 vjeç (4 raste), 20–29 vjeç (6 raste), 30–39 vjeç (1 rast), 40–49 vjeç (4 raste), 50–59 vjeç (12 raste) dhe 60–69 vjeç me 8 raste.

Grafikoni 1. Numri i rasteve të testuara, të konfirmuara me COVID-19, shtator 2025



7. SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME SËMUNDJE NGJITËSE NË RAJON DHE BOTË, SHTATOR 2025

Mbikëqyrja javore sezonale nga virusi i Nilit Perëndimor (WNV)

Që nga fillimi i vitit 2025 dhe deri më 24 shtator 2025, 12 vende në Evropë kanë raportuar raste humane të infeksionit nga virusi i Nilit Perëndimor (WNV). Numri i rasteve këtë vit është mbi mesataren e dekadës së fundit për të njëjtën periudhë, por më i ulët se në vitet me qarkullim të lartë si 2018, 2022 dhe 2024. Në Itali po ndodh një shpërthim i madh me 500 raste dhe 32 vdekje, që përfaqësojnë shkallë vdekshmërie prej 6.4%. Ky është numri më i lartë i rasteve të raportuar ndonjëherë nga Italia për këtë periudhë të vitit. Shumica e rasteve janë në rajonet Lazio dhe Campania. Deri më tani, janë raportuar raste në 100 rajone të nëntë vendeve, më pak se në 2024 dhe 2018. Për herë të parë, gjatë këtij sezoni, janë raportuar raste në disa rajone të Italisë, Francës dhe Rumanisë ku më parë nuk kishte pasur raste. Si në vitet e mëparshme, shumica e rasteve janë te meshkujt mbi 65 vjeç. Shkalla e shtrimeve në spital është 91%, e krahasueshme me vitet e kaluara, gjë që pasqyron se rastet më të rënda janë ato që kapen nga mbikëqyrja. Vdekshmëria është 6%, më e ulët se 11% e dekadës së kaluar. Manifestimet neurologjike janë raportuar në 54% të rasteve, më pak se 67% më parë.

Mbikëqyrja mujore e epidemive të fruthit nga Evropa

Që nga marsi i vitit 2025, është vërejtur një rënie e përgjithshme e rasteve të raportuara. Një rënie e mëtejshme e numrit të rasteve pritej gjatë muajve të verës, në përputhje me sezonalitetin e njohur të fruthit. Në korrik 2025, 30 vende raportuan të dhëna për fruthin, me 188 raste të raportuara nga 13 vende. Nga 17 vende u raportuan zero raste. Në përgjithësi, numri i rasteve u ul krahasuar me muajin e kaluar, megjithatë kjo mund të ndryshojë në rast të një përditësimi retrospektiv në të ardhmen. Numri më i lartë i rasteve u raportua nga Franca (59), Rumania (35), Belgjika (26), Italia (25) dhe Holanda (14). Midis 1 gushtit 2024 dhe 31 korrikut 2025, 30 shtete anëtare të BE/EEA raportuan një total prej 11 943 rastesh të fruthit, 8 545 (71.5%) prej të cilave u konfirmuan në laborator. Nga 11, 943 raste me moshë të njohur, 4,938 (41.4%) ishin fëmijë nën pesë vjeç; dhe 3, 766 (31.5%) raste ishin të moshës 15 vjeç e lart. Shkallët më të larta të raportimit u vunë re te foshnjat nën një vjeç (399.8 raste për milion) dhe fëmijët e moshës 1-4 vjeç (209.6 raste për milion). Nga 11, 126 raste (93.2% e të gjitha rasteve) me moshë dhe status vaksinimi të njohur, 9, 266 (83.3%) ishin të pavaksinuar, 1, 015 (9.1%) u vaksinuan me një dozë të vaksines që përmbante fruthin, 713 (6.4%) u vaksinuan me dy ose më shumë doza, dhe 113 (1.0%) nuk ishin të sigurtë me sa doza u vaksinuan. Gjatë periudhës 12-mujore, tetë vdekje (shkalla e vdekshmërisë së rasteve (CFR): 0.1 që i atribuohen fruthit u raportuan në ECDC nga Rumania (pesë), Franca (dy) dhe Holanda (një). Të dhëna të hollësishme janë të disponueshme në Atlasin e Mbikëqyrjes së Sëmundjeve Infektive të ECDC-së. Sipas raportit javor të kërcënimeve nga sëmundjet ngjitëse, Java 37, 6 - 12 Shtator 2025, është bërë mbikëqyrje plotësuese e inteligjencës epidemike, me mbledhjen e të dhënave midis 8 dhe 9 Shtatorit 2025. dhe nuk janë zbuluar shpërthime të mëdha dhe në përgjithësi është vërejtur një rënie e rasteve të fruthit.

Raste me Malarie, Greqi – P. falciparum malaria

Greqia raportoi dy raste të malaries me P. falciparum ku ka prova të transmetimit/futjes së mundshme lokale (transmetimi i gjeneratës së parë), në lidhje me dy migrantë me kombësi të huaj, të cilët mbërritën në Greqi në tetor 2024, nga një vend endemik i malaries në nënkontinentin Indian, me një lidhje epidemiologjike midis tyre. Fillimi i simptomave (për të dy) ishte në javën 31/2025 (27 korrik - 2 gusht 2025), dhe vendi i mundshëm i ekspozimit është një fshat rural në Bashkinë e Thivës,

Njësia Rajonale (NR) e Voiotës, në Rajonin e Greqisë Qendrore (Sterea Ellada). Nuk u zbuluan më raste të malaries në fshat gjatë hetimit në terren.

ECDC vlerëson se mundësia e infeksionit për qytetarët e BE-së/EEA-së që jetojnë ose udhëtojnë në zona ku dhe kur vektorët kompetentë janë të pranishëm dhe aktivë konsiderohet shumë e ulët. Duke pasur parasysh ashpërsinë e sëmundjes, ndikimi konsiderohet të jetë i ulët. Në përgjithësi, rreziku (gjasat x ndikimi) i infeksionit për qytetarët e BE-së/EEA-së që jetojnë ose udhëtojnë në zona të tilla konsiderohet i ulët.

Epidemia e Salmonelës në Austri

Më shumë se 40 persona janë infektuar me një lloj të rrallë të Salmonelës në Austri. Agjencia Austriake për Shëndetin dhe Sigurinë Ushqimore (AGES) tha se 49 persona të sëmurë vijnë nga të nëntë shtetet federale dhe janë infektuar me Salmonella Kenya që nga gushti i vitit 2025. Rastet përfshijnë 29 femra dhe 20 meshkuj, me një moshë mesatare prej 43 vjeç dhe një shpërndarje nga 4 deri në 86 vjeç. Pacientët jetojnë në Burgenland, Carinthia, Austria e Poshtme, Austria e Epërme, Salzburg, Steiermark, Vorarlberg dhe Vjenë. Pesëmbëdhjetë persona kishin nevojë për trajtim spitalor. Ministria e Shëndetësisë i kërkoi AGES dhe shteteve të prekura të hetojnë shpërthimin e shkaktuar nga ushqimi, por burimi nuk dihet ende. Salmonella Kenya është e rrallë në Evropë. Megjithatë, disa vende të tjera evropiane kanë raportuar gjithashtu raste të fundit të këtij lloji të Salmonelës. Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC) nuk tha se cilat vende të tjera ishin të përfshira, por një zëdhënës tha se agjencia po monitoronte situatën nëpërmjet platformës EpiPulse. EpiPulse është një portal online për autoritetet evropiane të shëndetit publik për të mbledhur, analizuar, ndarë dhe diskutuar të dhënat e sëmundjeve ngjitëse.

Shpërthim i E. coli në Belgjikë

Në Belgjikë është raportuar një shpërthim i E. coli me mbi 70 raste dhe nëntë viktime, i lidhur me konsumimin e mishit të grirë të papërpunuar. Agjencia Federale për Sigurinë e Rrjetit Ushqimor (FASFC) njoftoi se nuk janë marrë mostra nga pakoja e mishit të prekur, ndaj burimi i saktë i kontaminimit nuk mund të konfirmohet me siguri absolute. Në përpjekje për të identifikuar burimin, është realizuar një hetim epidemiologjik duke analizuar konsumin ushqimor në shtëpitë e pleqve të prekura dhe duke testuar mostra të ndryshme ushqimore. Të dhënat epidemiologjike dhe hetimet e gjurmimit të produktit tregojnë se mishi i grirë i papërpunuar ishte burimi më i mundshëm i kontaminimit. Në gusht janë regjistruar infeksione me të njëjtin tip Shiga-toksinë prodhuese E. coli (STEC) O157 në 11 shtëpi pleqsh në Belgjikë. Prokuroria e Brukselit ka hapur një hetim gjyqësor lidhur me kontaminimin me STEC në këto institucione. Në vitin 2024 Belgjika raportoi katër shpërthime të STEC me 14 të prekur. Hetimi u zhvillua në bashkëpunim mes Departamentit të Shëndetit të Flandrisë, FASFC, Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik Sciensano, dhe agjencive Vivalis dhe Aviq që mbulojnë shëndetin dhe sigurinë në rajonet përkatëse. Analiza e ushqimit së të prekurve para fillimit të simptomave konfirmoi se mishi i grirë i papërpunuar ishte shkaku më i mundshëm i infeksioneve. Hetimet e gjurmueshmërisë zbuluan se të gjitha shtëpitë e pleqve që u prekën kishin përdorur mish nga i njëjti furnizues. Më shumë se 70 mostra ushqimore nga ushqimet e mbetura dhe zinxhiri i furnizimit u testuan, por mungesa e mostrave nga pakoja e mishit të kontaminuar pengoi konfirmimin laboratorik të burimit të saktë.

Shpërthim i E. coli në Gjermani

Autoritetet gjermane po hetojnë një shpërthim të E. coli O45:H2 që ka prekur 121 persona, kryesisht fëmijë. Deri tani, 67 raste janë konfirmuar, ndërsa 20 persona kanë zhvilluar sindromën hemolitike-uremike (HUS), një komplikacion serioz që mund të çojë në dështim të veshkave. Shpërthimi u identifikua fillimisht në rajonin Mecklenburg-Vorpommern, ku rastet ishin të lidhura me pushues. Burimi i infeksionit mendohet të jetë ushqim i kontaminuar, por ende nuk është konfirmuar. Po zhvillohen intervista epidemiologjike dhe një studim rast-kontroll për të zbuluar shkaktarin.

Shpërthimet e *Campylobacter* në Danimarkë

Midis 14 korrikut dhe 13 shtatorit 2025, Instituti Statens Serum (SSI) ka regjistruar dy shpërthime të bakterit *Campylobacter jejuni*, me gjithsej 57 të sëmurë në Danimarkë. Rastet përfshijnë pacientë të moshave nga 2 deri në 89 vjeç dhe janë raportuar nga të gjitha rajonet e vendit. Rreth gjysma e pacientëve kanë kërkuar hospitalizim. SSI vlerëson se numri i të infektuarve mund të jetë disa qindra, pasi vetëm një pjesë e vogël e rasteve janë raportuar, që do të thotë se numri real i të sëmurëve në këto shpërthime mund të jetë shumë më i madh. Një raport paraprak tregoi se dy shpërthimet kishin përkatësisht 20 dhe 12 raste. Aktualisht, njera nga shpërthimet ka 40 raste, ndërsa tjetra 17. Në total, 30 meshkuj dhe 27 femra janë konfirmuar të sëmurë. *Campylobacter* është shkaku kryesor i infeksioneve bakteriale në Danimarkë, dhe mishi i pulës është burimi më i shpeshtë i këtyre rasteve. Në vitin 2024, 7 nga 10 shpërthimet ishin të lidhura me mish pule. Gjithsej janë raportuar 5,546 raste, krahasuar me 5,186 raste në vitin 2023. Llojet e njëjta të sekuencës gjenetike që janë gjetur në pacientët e këtyre dy shpërthimeve janë identifikuar gjithashtu në mishin e pulës daneze. Krahasimi i mostrave pozitive humane me ato nga produktet dhe ambienti ka ndihmuar në identifikimin e mishit të pulës daneze si burimi i infeksionit në këto shpërthime.

8. REKOMANDIMET

Për ngritjen e kualitetit të raportimit, mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe aplikimin e masave parandaluese dhe kundërepidemike me kohë rekomandojmë:

Bazuar në Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr.08/L-200, Neni 20 dhe 21 të gjitha Institucionet shëndetësore obligohen të raportojnë në IKSHPK/QRSHIP sipas listës së sëmundjeve ngjitëse Aneksi 1 i këtij ligji.

Raportimi i sëmundjeve të bëhet përmes sistemit të digjitalizuar të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse në të gjitha nivelet me qëllim të sigurimit të të dhënave në kohë reale, të dhëna kualitative dhe pasqyrë reale të situatës epidemiologjike për parandalim dhe kontrollë të sëmundjes.

INSITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË

PUBLIKE TË KOSOVËS

Departamenti i Epidemiologjisë

Adresa: R. Instituti Shëndetësor Nr. 12, Prishtinë 10000

WebFaqe: <http://www.niph-rks.org>

E-mail: QOE.IKSHP@rks-gov.net

Telefoni+38338 541432
